



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 14.nëntor 2011  
Nr. ref.: RK159/11

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI 16-11**

Parashtruesi

**Shemsedin Ademi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2009 për  
Regjistrimin e Automjeteve, të 14 shtatorit 2009**

**GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues është z. Shemsedin Ademi, me vendbanim në fshatin Pozharan të komunës së Vitisë.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi e konteston Udhëzimin Administrativ Nr. 14/2009 për Regjistrimin e Automjeteve, të nxjerrë nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB). Parashtruesi thekson që MPB-ja, duke i obliguar qytetarët që të paguajnë taksa pa bazë të duhur juridike, është duke vepruar në kundërshtim me nenin 21.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

## **Baza juridike**

3. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 dhe 116.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 20 dhe 27 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullat 55 dhe 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e Punës).

## **Procedura në Gjykatë**

4. Parashtruesi e parashtri kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 11 shkurt 2011.
5. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar Raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Gjyljeta Mushkolaj.
6. Gjykata Kushtetuese e shqyrtoi këtë kërkesë më 7 korrik 2011.

## **Përmbledhja e fakteve**

7. Më 28 janar 2011, parashtruesi ishte duke përdorur targat 316-KS-264 në makinën e tij. Ai shkoi në Qendrën Komunale të Regjistrimit të Automjeteve në Viti për ta vazhduar regjistrimin e automjetit. Atje, një punëtor i qendrës kërkoi nga parashtruesi që t'i dorëzonte targat 316-KS-264.
8. Parashtruesi i dorëzoi targat 316-KS-264 dhe u ngarkua me një taksë të re prej 20 (njëzet) eurove për targat e reja.
9. Parashtruesi e dorëzoi edhe fletëpagesën Nr. 1320000204, të 12 janarit 2011, bashkë me kërkesën e tij.
10. Parashtruesi pohon se ka kërkuar sqarim për pagesën për targat e reja pasi ai i kishte dorëzuar targat 316-KS-264 të padëmtuara, dhe stafi i tha se ata duhej të bënin kështu.

## **Argumentet ligjore të paraqitura nga parashtruesi**

11. Parashtruesi pohon se targat e tij nuk ishin të dëmtuara dhe se u ngarkua gabimisht me 20 euro dhe jo sipas nenit 11.3 të Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2009 për Regjistrimin e Automjeteve. Neni 11.3 përcakton:

*“Në rastin e dëmtimit të DRA-së, ose targave, pala duhet që DRA-në e dëmtuar ose targat t’ia prezantoj QKRA-së dhe më pas ai e merr DRA-në e re ose targat, të cilën e paguan sipas Vendimit mbi Tarifat, ndërsa DRA e dëmtuar ose target arkivohen.”*

12. Parashtruesi pohon se faktet e përmendura paraqesin një realitet të shkeljes së të drejtave të njeriut nga MPB-ja. Përveç kësaj, ai thotë që detyrimi i qytetarëve për të

paguar taksa pa bazë juridike është në kundërshtim me nenin 21.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Neni 21.1 përcakton:

*“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës”.*

13. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese:

- të lejojë “zbatim të menjëhershëm të masës së përkohshme deri në gjykimin kryesor kundër MPB-së për ndërprerjen e zbatimit të taksës administrative në shumë prej 20 eurove për targat e reja me rastin e regjistrimit të automjetit, dhe
- të vendosë në favor të qytetarëve dhe t’i mbrojë të drejtat e tyre duke pezulluar Udhëzimin Administrativ Nr. 14/2009, i cili kërkon pagesën prej 20 eurove për targat të reja të automjetit, deri në lëshimin e vendimit mbi meritat e rastit.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

14. Kriteret e pranueshmërisë janë të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës

15. Neni 113.1 dhe 113.7 i Kushtetutës përcakton kornizën e përgjithshme ligjore që kërkohet për pranueshmëri. Ai përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*(...)*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

16. Në bazë të dokumenteve të dorëzuara nga parashtruesi, përkundër këshillës së Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 12 dhjetorit 2008, se ai mund të ushtrojë ankesë kundër aktgjyimit të saj në Gjykatën Supreme të Kosovës, ai nuk e ka shfrytëzuar këtë të drejtë ligjore.

17. Gjykata gjithashtu vëren që një dyshim i thjeshtë lidhur me perspektivën e çështjes nuk mjafton për ta përjashtuar parashtruesin nga obligimet e tij për të parashtruar ankesë në organet kompetente (shih Whiteside kundër Mbretërisë së Bashkuar, Vendimi i 7 marsit 1994, Kërkesa Nr. 2035/92, DR 76, f. 80).

18. Më parë, Gjykata ka theksuar se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t’ua lejojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjet efikas juridik për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, Nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999). Megjithatë, nuk është e nevojshme që të drejtat kushtetuese të cekën në mënyrë eksplicite në procedurën në fjalë. Nëse çështja është ngritur në mënyrë implicite ose në substancë, rregulli i shterimit të mjeteve juridike është plotësuar (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Azinas kundër Qipros, Nr. 56679/00, Vendimi i 28 prillit 2004).

19. Gjykata zbatoi të njëjtin arsyetim kur nxori Aktvendimin për Papranueshmëri më 27 janar 2010 për shkak të mosshtrimit të mjeteve juridike në Rastin Nr. KI41/09,

Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe në Vendimin e vet të 23 marsit 2010 në Rastin Nr. KI. 73/09, Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror Zgjedhor.

## **Masa e përkohshme**

20. Neni 116.2 i Kushtetutës përcakton:

*Neni 116 [Efekti Juridik i Vendimeve]*

*2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme.*

21. Neni 27 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese thotë:

*Neni 27 Masat e përkohshme*

*1. Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.*

*2. Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale.*

22. Njëri nga kriteret për lejimin e masës së përkohshme është nëse dëme të pariparueshme do të shkaktohen. Sikur Gjykata të gjente që vendimi i kontestuar ishte jokushtetues, atëherë çfarëdo dëmi që i është shkaktuar parashtruesit do të mund të llogaritet dhe do të urdhëronte që t'i paguheshin parashtruesit. Prandaj, parashtruesi nuk do t'i shkaktohej humbje.

23. Parashtruesi nuk ka dorëzuar argumente bindëse që Gjykata duhet ta pezullojë Udhëzimin Administrativ Nr. 14/2009 për Regjistrimin e Automjeteve, të nxjerrë nga MPB-ja.

24. Prandaj, parashtruesi nuk e ka mbështetur me prova dëmin e pariparueshëm që gjoja do të t'i shkaktohej apo që masa e përkohshme do të ishte në interes publik. Si rrjedhojë, Gjykata e refuzon kërkesën për masë të përkohshme.

25. Gjykata gjithashtu gjen që parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion të parapara me ligj.

## PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullit 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri

### VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. TA HEDHË POSHTË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

Almiro Rodrigues



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. Dr. Enver Hasani

